



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, 25 mars 2019
Nr. ref.:RK 1339/19

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KO131/18

Parashtrues

Presidenti i Republikës së Kosovës

Kërkesë për vlerësim të konfliktit në mes të kompetencave kushtetuese të Presidentit të Republikës së Kosovës dhe Kuvendit të Republikës së Kosovës, siç është përcaktuar me nenin 113.3 (1) të Kushtetutës

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Presidenti i Republikës së Kosovës, Shkëlqesia e Tij, Hashim Thaçi (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Objekti i çështjes

2. Objekt i çështjes është kërkesa për vlerësim të konflikt të kompetencës kushtetuese në mes të Presidentit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Presidenti) dhe Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kuvendi).
3. Pretendimi për konflikt të kompetencës kushtetuese ndërlidhet me kompetencat kushtetuese të përcaktuara për Presidentin dhe Kuvendin në nenin 18 [Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare] të Kushtetutës. Presidenti, si palë që ka ngritur pretendim për konflikt në mes Presidentit dhe Kuvendit pretendon paqartësi rreth kompetencës kushtetuese për ratifikimin e Shkëmbimit të Letrave në mes Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian, si në vijim:

“1. Letrat e shkëmbimit në mes të Presidentit të Republikës së Kosovës (04.06.2018) dhe Përfaqësueses së Lartë të Bashkimit Evropian për Punë të Jashtme dhe Politika të Sigurisë (08.06.2018) [Shkëmbimi i Katërt i Letrave]:

- 1.1. *a duhet të ratifikohen në cilësinë e Marrëveshjes Ndërkombëtare, nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, me votat e dy të tretave (2/3) të të gjithë deputetëve (në pajtim me Nenin 18.1. të Kushtetutës) apo*
- 1.2. *a duhet të konsiderohen të ratifikuara pas nënshkrimit nga Presidenti (në pajtim me Nenin 18.2 të Kushtetutës), për shkak të ndërrimit të rolit dhe mandatit ekzekutiv të Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë, pasi që tani e tutje do të ketë rol kryesisht këshillëdhënës dhe monitorues.”*

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nën-paragrafin (1) të paragrafit 3 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], paragrafin 9 të nenit 84 [Kompetencat e Presidentit] të Kushtetutës, në nenet 31 [Saktësimi i kërkesës] dhe 32 [Afatet] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe rregullin 68 [Kërkesa në pajtim me nenin 113.3 (1) të Kushtetutës dhe me nenet 31 dhe 32 të Ligjit] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 4 shtator 2018, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Gjykata). Parashtruesi i kërkesës kërkoi nga Gjykata interpretimin e nenit 18 të Kushtetutës bazuar në nenin 83 [Statusi i Presidentit] dhe paragrafin 9 të nenit 84 të Kushtetutës. Presidenti

pretendoj paqartësi kushtetuese që ndërliidhen me autoritetin kompetent për Shkëmbimin e Letrave të lartreferuara.

6. Më 7 shtator 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Gresa Caka-Nimani Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu (kryesues), Bajram Latifi dhe Nexhmi Rexhepi.
7. Më 12 shtator 2018, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës.
8. Të njëjtën datë, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, z. Kadri Veseli (në tekstin e mëtejme: Kryetari i Kuvendit) me kërkesën që e njëjta t'i dorëzohet të gjithë deputetëve të Kuvendit. Me atë rast, Gjykata e ftoi Kryetarin e Kuvendit dhe deputetët e Kuvendit që të dorëzojnë komentet e tyre, nëse kanë, deri më 28 shtator 2018. Brenda afatit të përcaktuar, z. Korab Sejdiu, deputet i Kuvendit si dhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes VETËVENDOSJE! të përfaqësuar nga z. Sami Kurteshi, dorëzuan komentet e tyre në Gjykatë.
9. Të njëjtën datë, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj (në tekstin e mëtejme: Kryeministri) dhe e ftoi atë që të dorëzojë komentet e tij lidhur me kërkesën deri më 28 shtator 2018. Brenda afatit të përcaktuar, Kryeministri nuk dorëzoi ndonjë koment në Gjykatë.
10. Më 1 tetor 2018, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës, Kryeministrin dhe Kryetarin e Kuvendit lidhur me komentet e dorëzuara nga deputeti z. Korab Sejdiu dhe nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes VETËVENDOSJE!, si dhe u dërgoi një kopje të atyre komenteve për informatën e tyre.
11. Më 12 nëntor 2018, në cilësinë e palës së interesuar, Gjykata e njoftoi Shefen e Misionit të EULEX-it, znj. Alexandra Papadopoulou, për regjistrim të kërkesës dhe e ftoi atë që të dorëzojë komentet e EULEX-it, nëse ka, deri më 23 nëntor 2018.
12. Më 23 nëntor 2018, Shefja e Misionit të EULEX-it, znj. Alexandra Papadopoulou, dorëzoi komentet e saj në Gjykatë.
13. Më 3 dhjetor 2018, Gjykata publikoi Aktvendim për Papranueshmëri në rastin KO79/18, ku parashtrues i kërkesës ishte Presidenti. Në atë rast, Presidenti, në bazë të paragrafit (9) të nenit 84 të Kushtetutës, kishte kërkuar nga Gjykata që të interpretojë paragrafin (4) të nenit 139 [Komisioni Qendror i Zgjedhjeve] të Kushtetutës. Gjykata e kishte shpallur kërkesën të papranueshme dhe kishte konstatuar se neni 84 (9) nuk është i pavarur prej nenit 113 të Kushtetutës dhe se parashtrimi i çështjeve kushtetuese në Gjykatë duhet të bëhet vetëm mbi bazën e nenit 113 të Kushtetutës.
14. Më 11 dhjetor 2018, Gjykata, duke pasur parasysh faktin që kërkesa KO131/18 ishte dorëzuar në Gjykatë, para vendimmarrjes së saj në rastin KO79/18, ku përcaktoi se kërkesat e Presidentit në Gjykatë nuk mund të bazohen vetëm në nenin 84 (9) të Kushtetutës, por janë të ndërliidhura me nenin 113 të saj, kërkoi

nga parashtruesi i kërkesës që të sqarojë kërkesën e tij dorëzuar në Gjykatë, duke i dhënë kështu mundësinë që ta sqarojë dhe arsyetojë pranueshmërinë e kërkesës KO131/18. Gjykata po ashtu e njoftoi parashtruesin e kërkesës lidhur me komentet e dorëzuara nga Misioni i EULEX-it si dhe i dërgoi një kopje të tyre. Gjykata kërkoi nga parashtruesi i kërkesës që sqarimet e tij lidhur me pranueshmërinë e kërkesës si dhe komentet e tij ndaj komenteve të EULEX-it, nëse ka, t'i dorëzojë në Gjykatë deri më 24 dhjetor 2018.

15. Më 24 dhjetor 2018, parashtruesi i kërkesës dorëzoi sqarimet e tij në Gjykatë, duke ngritur pretendime për konfliktit të kompetencës kushtetuese në mes të Presidentit dhe Kuvendit, bazuar në nën-paragrafin (1) të paragrafit 3 të nenit 113 të Kushtetutës lidhur me kompetencat kushtetuese të përcaktuara në nenin 18 të Kushtetutës. Parashtruesi i kërkesës nuk dorëzoi ndonjë koment lidhur me komentet e EULEX-it.
16. Më 28 dhjetor 2018, Gjykata i dërgoi Kryetarit të Kuvendit një kopje të kërkesës për sqarim të Gjykatës drejtuar parashtruesit të kërkesës si dhe një kopje të sqarimeve të dorëzuara në Gjykatë nga parashtruesi i kërkesës. Atij iu kërkua që dokumentacionin në fjalë t'ua shpërndajë të gjithë deputetëve të Kuvendit me ftesën që të dorëzojnë komentet e tyre, nëse kanë, deri më 18 janar 2019.
17. Më 8 janar 2019, Kryetar i Kuvendit e njoftoi Gjykatën se Kuvendi e ka përmbyllur sesionin vjeshtor të punimeve dhe se deputetët janë në pushim deri më 21 janar 2019.
18. Më 18 janar 2019, Gjykata sërish ia dha mundësinë Kryetarit të Kuvendit dhe deputetëve të Kuvendit që të dorëzojnë komentet e tyre përkitazi me sqarimet e ofruara nga parashtruesi i kërkesës, veçanërisht lidhur me pretendimin e tij për *"konfliktit të kompetencës ndërmjet Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Presidentit të Republikës së Kosovës"* për çështje që përcaktohen nga neni 18 i Kushtetutës. Atij iu kërkua që dokumentacionin në fjalë t'ua shpërndajë të gjithë deputetëve të Kuvendit me ftesën që të dorëzojnë komentet e tyre, nëse kanë, deri më 1 shkurt 2019. Gjykata nuk pranoi ndonjë koment nga Kryetari apo deputetët e Kuvendit.
19. Më 6 mars 2019, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtares raportuese Gresa Caka-Nimani dhe, njëzëri, votoi kundër propozimit të Gjyqtares raportuese për ta shpallur kërkesën të pranueshme dhe për shqyrtimin e çështjes në merita.
20. Në të njëjtën datë, Gjykata, me shumicë votash, vendosi që ta shpallë kërkesën të papranueshme. Gjyqtarja Gresa Caka Nimani votoi kundër papranueshmërisë së kërkesës.
21. Në të njëjtën datë, Gjyqtarja raportuese në bazë të paragrafit (4) të rregullit 58 (Këshillimet dhe Votimi) të Rregullores së punës, kërkoi nga Kryetarja e Gjykatës që të caktohet një gjyqtar tjetër, nga shumica, për të përgatitur Aktvendimin për pranueshmëri.

22. Në të njëjtën datë, në bazë të rregullit të lartcekur, Kryetarja e Gjykatës e caktoi gjyqtarin Bajram Ljatifi, si njërin nga gjyqtarët e Kolegjit shqyrtues, për të përgatitur Aktvendimin për papranueshmëri.
23. Më 13 mars 2019, gjyqtari Bajram Ljatifi prezantoi Aktvendimin për papranueshmëri para Gjykatës.
24. Më 14 mars 2019, Aktvendimi për papranueshmëri u qarkullua tek të gjithë gjyqtarët në pajtim me paragrafin 8 të nenit 22 të Ligjit dhe paragrafin (2) të rregullit 64 të Rregullores së punës.
25. Më 25 mars 2019, Gjykata publikoi Aktvendimin për papranueshmëri, pas kalimit të afatit dhjetë (10) ditor të paraparë me Ligj dhe Rregullore të punës.

Përmbledhja e fakteve

26. Më 4 shkurt 2008, Këshilli i Bashkimit Evropian miratoi Veprimin e Përbashkët të Këshillit ("*Council Joint Action*" 2008/124/CFSP) për Misionin e Sundimit të Ligjit të Bashkimit Evropian (në tekstin e mëtejme: Veprimi i Përbashkët i Këshillit) përmes së cilit u themelua Misioni i EULEX-it në Kosovë. (Shih nenin 1 (Misioni) të Veprimit të Përbashkët të Këshillit).
27. Veprimi i Përbashkët i Këshillit, në nenin 2 (Deklarata e Misionit) të tij përcaktonte që EULEX do të ndihmojë institucionet e Kosovës, autoritetet gjyqësore dhe agjencitë për zbatim të ligjit në përparimin e tyre drejt qëndrueshmërisë dhe llogaridhënies si dhe në zhvillimin e forcimit të mëtejme të një sistemi shumetnik të drejtësisë, policisë e shërbimit doganor, duke siguruar që këto institucione të jenë të lira nga ndërhyrjet politike dhe të njëjtat të aderojnë në standardet e njohura ndërkombëtarisht dhe praktikat më të mira Evropiane. Më tutje, neni 3 (Detyrat) i Veprimit të Përbashkët të Këshillit listonte detyrat që EULEX do të ketë në misionin e saj fillestar. EULEX kishte për detyrë të monitorojë, mentorojë dhe këshillojë institucionet kompetente të Kosovës në të gjitha fushat lidhur me sundimin e ligjit, përfshirë shërbimin doganor, duke mbajtur disa kompetenca ekzekutive. Dy nenet e fundit të Veprimit të Përbashkët i Këshillit përcaktonin hyrjen në fuqi, kohëzgjatjen dhe publikimin. Sipas nenit 20 (Hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja), Veprimi i Përbashkët i Këshillit përcaktonte që ky dokument hyn në fuqi ditën e miratimit të tij dhe se të njëjtit do t'i mbarojë afati pas 28 muajsh nga dita e miratimit të Planit Operativ.
28. Më 17 shkurt 2008, Udhëheqësit e popullit të Kosovës të mbledhur në Kuvend, shpallën Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës, ku, mes tjerash, u deklaruan se: "*Ne ftojmë dhe mirëpresim një prani ndërkombëtare civile për të mbikëqyrur zbatimin e Planit të Ahtisaarit dhe një mision të sundimit të ligjit të udhëhequr nga Bashkimi Evropian*".
29. Më 9 prill 2008, u publikua Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Neni 162 [Hyrja në fuqi] i Kushtetutës përcaktonte që Kushtetuta do të hyjë në fuqi më 15 qershor 2008.

30. Deri në vitin 2012, mandati i EULEX-it ishte modifikuar dhe vazhduar edhe dy herë mbi bazën e vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian për amendamentimin e Veprimit të Përbashkët të Këshillit, përmes Vendimit 2009/445/CFSP të 9 qershorit 2009, dhe Vendimit 2010/322/CFSP të 8 qershorit 2010, respektivisht. (Shih Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian).
31. Më 7 shtator 2012, Kushtetuta u amendamentua për herë të parë me 22 amendamente të cilat kishin të bëjë me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës.
32. Me përfundimin e pavarësisë së mbikëqyrur, mandati i EULEX-it u vazhdua përmes Shkëmbimit të Letrave në mes Bashkimit Evropian dhe Republikës së Kosovës, të cilat u ratifikuan nga Kuvendi përmes ligjeve për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, Ligjit Nr. 04/L-148, Ligjit Nr. 04/L-274, dhe Ligji Nr. 05/L-102 për Ratifikimin e Marrëveshjes Ndërkombëtare në mes Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi Misionin e Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë, respektivisht.

Marrëveshja e Parë Ndërkombëtare për vazhdimin e mandatit të EULEX-it në Kosovë - Ligji Nr. 04/L-148 për Ratifikimin e Marrëveshjes Ndërkombëtare në mes të Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi Misionin e Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë

33. Më 5 qershor 2012, Këshilli i Bashkimit Evropian përmes Vendimit 2012/291/CFSP amendamentoi Veprimin e Përbashkët të Këshillit duke modifikuar dhe vazhduar mandatin e EULEX-it deri më 14 qershor 2014.
34. Më 4 shtator 2012, Presidentja e Republikës së Kosovës, Shkëlqesia e Saj, znj. Atifete Jahjaga, nëpërmjet një letre, e ftoi Përfaqësuesen e Lartë të Bashkimit Evropian për Politika të Jashtme dhe të Sigurisë (në tekstin e mëtejme: Përfaqësuesja e Lartë), Shkëlqesinë e Saj, Baroneshën Catherine Ashton, që të pajtohet për vazhdimin e parë të mandatit të EULEX-it deri më 15 qershor 2014.
35. Letra e lartpërmendur bazohej në disa dispozita kushtetuese, përkatësisht paragrafin (1) të nenit 17 [Marrëveshjet Ndërkombëtare], paragrafin (1) të nenit 18, dhe paragrafin (1) të nenit 20 [Bartja e Sovranitetit] të Kushtetutës. Letra përcaktoi kompetencat e EULEX-it për periudhën e mandatit të EULEX-it deri më 15 qershor 2014.
36. Në të njëjtën datë, Përfaqësuesja e Lartë, nëpërmjet një letre, pranoi ftesën e Presidentes për vazhdim të mandatit të EULEX-it deri në datën e propozuar.
37. Letrat e Presidentes dhe Përfaqësueses së Lartë, të datës 4 shtator 2012, përbëjnë Shkëmbimin e parë të Letrave në mes të Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian, që përbënin hapin e parë në procesin e lidhjes së marrëveshjes së parë ndërkombëtare për vazhdimin e mandatit të EULEX-it në bazë të paragrafit 1 të nenit 18 të Kushtetutës.

38. Më 7 shtator 2012, Kuvendi ratifikoi Shkëmbimin e parë të Letrave, në mes të Presidentes së Republikës së Kosovës dhe Përfaqësueses së Lartë. (Shih Ligjin nr. 04/L-148 për Ratifikimin e Marrëveshjes Ndërkombëtare në mes Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi Misionin e Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë).
39. Në të njëjtën datë, pra më 7 shtator 2012, Presidentja e Republikës së Kosovës përmes Dekretit Nr. DL-039-2012 e shpalli Ligjin e lartpërmendur. Në bazë të nenit 3 [Hyrja në Fuqi] të Ligjit nr. 04/L-148, ai hyri në fuqi në ditën që u nënshkrua nga Presidentja e Republikës së Kosovës.

Marrëveshja e dytë Ndërkombëtare për vazhdimin e mandatit të EULEX-it në Kosovë - Ligji Nr. 04/L-274 për Ratifikimin e Marrëveshjes Ndërkombëtare në mes Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi Misionin e Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë

40. Më 14 prill 2014, Presidentja e Republikës së Kosovës, Shkëlqesia e Saj, znj. Atifete Jahjaga, nëpërmjet një letre të dytë të dërguar nga Presidenca e Republikës së Kosovës, e ftoi Përfaqësuesen e Lartë, Shkëlqesinë e Saj, Baroneshën Catherine Ashton, që të pajtohet për vazhdimin e dytë të mandatit të EULEX-it deri më 15 qershor 2016.
41. Letra e lartpërmendur bazohej në të njëjtat dispozita kushtetuese sikurse Shkëmbimi i parë i Letrave, përkatësisht në paragrafin (1) të nenit 17, paragrafin (1) të nenit 18, dhe paragrafin (1) të nenit 20 të Kushtetutës. Letra përcaktoi kompetencat e EULEX-it për periudhën e mandatit të EULEX-it deri më 14 qershor 2016.
42. Në një datë të pacaktuar, Përfaqësuesja e Lartë e BE-së, nëpërmjet një letre, pranoi ftesën e Presidentes për vazhdim të mandatit të EULEX-it deri në datën e propozuar.
43. Letrat e Presidentes dhe Përfaqësueses së Lartë përbëjnë Shkëmbimin e dytë të Letrave në mes të Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian, që përbënin hapin e parë në procesin e lidhjes së marrëveshjes së dytë ndërkombëtare për vazhdimin e mandatit të EULEX-it në bazë të paragrafit 1 të nenit 18 të Kushtetutës.
44. Më 23 prill 2014, Kuvendi ratifikoi Shkëmbimin e Dytë të Letrave, në mes të Presidentes dhe Përfaqësueses së Lartë. (Shih Ligjin nr. 04/L-274 për Ratifikimin e Marrëveshjes Ndërkombëtare në mes Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi Misionin e Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë).
45. Më 7 maj 2014, Presidentja me Dekretin Nr. DL-022-2014 e shpalli Ligjin e lartpërmendur, nr. 04/L-274.
46. Më 15 maj 2014, Ligji i lartpërmendur u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gazeta Zyrtare) dhe në bazë të

nenit 3 të Ligjit nr. 04/L-274, ai hyri në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas ditës së publikimit në Gazetën Zyrtare.

47. Më 12 qershor 2014, Këshilli i Bashkimit Evropian përmes Vendimit 2014/349/CFSP amendamento i Veprimin e Përbashkët të Këshillit duke modifikuar dhe vazhduar mandatin e EULEX-it deri më 14 qershor 2016.

Marrëveshja e Tretë Ndërkombëtare për vazhdimin e mandatit të EULEX-it në Kosovë - Ligji Nr. 05/L-102 për Ratifikimin e Marrëveshjes Ndërkombëtare mes Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi Misionin e Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë

48. Më 9 qershor 2016, Presidenti i Republikës së Kosovës, Shkëlqesia e Tij, z. Hashim Thaçi, nëpërmjet një letre të tretë të dërguar nga Presidenca e Republikës së Kosovës, e ftoi Përfaqësuesen e Lartë, znj. Federica Mogherini, që të pajtohet për vazhdimin e tretë të mandatit të EULEX-it deri më 15 qershor 2018.
49. Letra e lartpërmendur bazohej në të njëjtat dispozita kushtetuese sikurse Shkëmbimi i Parë dhe i Dytë i Letrave, përkatësisht në paragrafin (1) të nenit 17, paragrafin (1) të nenit 18, dhe paragrafin (1) të nenit 20 të Kushtetutës. Letra përcaktoi kompetencat e mandatit të EULEX-it për periudhën e mandatit të EULEX-it deri me 14 qershor 2018.
50. Në një datë të pacaktuar, Përfaqësuesja e Lartë pranoi ftesën e Presidentit për vazhdimin e tretë të mandatit të EULEX-it deri në datën e propozuar.
51. Letrat e Presidentit dhe të Përfaqësueses së Lartë përbëjnë Shkëmbimin e tretë të Letrave në mes të Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian, që përbënin hapin e parë në procesin e lidhjes së marrëveshjes së tretë ndërkombëtare për vazhdimin e mandatit të EULEX-it në bazë të paragrafit 1 të nenit 18 të Kushtetutës.
52. Më 14 qershor 2016, Këshilli i Bashkimit Evropian përmes Vendimit 2016/947/CFSP amendamento i Veprimin e Përbashkët të Këshillit duke modifikuar dhe vazhduar mandatin e EULEX-it deri më 14 qershor 2018.
53. Më 17 qershor 2016, Kuvendi ratifikoi Shkëmbimin e Tretë të Letrave, në mes të Presidentit dhe Përfaqësueses së Lartë. (Shih Ligjin nr. 05/L-102 për Ratifikimin e Marrëveshjes Ndërkombëtare mes Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi Misionin e Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë).
54. Më 29 qershor 2016, Presidenti me Dekretin Nr. DL-020-2016 shpalli Ligjin e lartpërmendur, nr. 05/L-102.
55. Në po të njëjtën datë, pra më 29 qershor 2016, Ligji i lartpërmendur u publikua në Gazetën Zyrtare dhe në bazë të nenit 3 të Ligjit nr. 05/L-102, ai hyri në ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare.

Shkëmbimi i katërt i Letrave në mes Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian për mandatin e EULEX-it në Kosovë

56. Më 4 qershor 2018, Presidenti i Republikës së Kosovës, Shkëlqesia e Tij, z. Hashim Thaçi, nëpërmjet një Letre të katërt të dërguar nga Presidenca e Republikës së Kosovës, e ftoi Përfaqësuesen e Lartë, znj. Federica Mogherini, që të pajtohet për vazhdimin e katërt të mandatit të EULEX-it, deri më 14 qershor 2020.
57. Në Letrën e lartpërmendur, nuk përmendej ndonjë nen i Kushtetutës, sikurse ishte bërë në Shkëmbimet e tjera të Letrave në mes të këtyre dy autoriteteve. Në letër, në mes tjerash, theksohej: *“Si rezultat i tranzicionit të kompetencave nga EULEX KOSOVA, të gjitha aktivitetet ekzekutive të ndërmarra nga EULEX KOSOVA lidhur me hetimet, ndjekjet, procedurat gjyqësore dhe të ekzekutimit që do transferohen, do të përfundojnë me datën 14 qershor 2018 dhe si rrjedhojë do ndërmerren ekskluzivisht nga autoritetet e Kosovës. Bazuar në legjislacionin përkatës, EULEX KOSOVA është i mirëseardhur të ushtroj rolin e tij monitorues në të gjitha rastet që i vlerëson të rëndësishme gjatë mbështetjes së vazhdueshme, përfshirë por jo kufizuar në qasjen e plotë në objekte, dokumente dhe zyrtarët e Kosovës. Bazuar në legjislacionin përkatës, dhe duke u bazuar në shkëmbimet tona paraprake të letrave, unë mirëpres angazhimin e misionit të EULEX KOSOVA në fushën e rendit publik dhe sigurisë, në mbrojtjen e dëshmitarëve dhe në mbështetje të Dhomave të Specializuara si dhe Prokurorit të Specializuar në Kosovë. Ne vazhdojmë të mbështesim në tërësi mandatin e EULEX KOSOVA ashtu si është paraparë në Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP/, të miratuar nga Këshilli i Bashkimit Evropian, me 4 shkurt 2008, dhe siç është amendamentuar me Vendim të Këshillit, dhe letrat tona të datës 4 shtator 2012, 14 prill 2014 dhe 9 qershor 2016, dhe dakorduar përmes kësaj letre.”*
58. Më 8 qershor 2018, Këshilli i Bashkimit Evropian, përmes Vendimit 2018/856/CFSP, pas Shkëmbimit të katërt të Letrave, e amendamentoi Veprimin e Përbashkët të Këshillit. Nëpërmjet nenit 1 të këtij Vendimi u ndryshua neni 2 (Deklarata e Misionit) i Veprimit të Përbashkët të Këshillit ashtu që Misioni i EULEX-it tanimë do të ishte: *“EULEX KOSOVA do të mbështesë disa institucione të përzgjedhura të sundimit të ligjit në rrugën e tyre drejt ngritjes së efikasitetit, qëndrueshmërisë, shumëetnicitetit dhe llogaridhënies, lirisë nga ndërhyrjet politike dhe në përputhshmëri të plotë me standardet ndërkombëtare për mbrojtje të drejtave të njërit dhe praktikave me të mira Evropiane – nëpërmjet aktiviteteve monitoruese dhe funksioneve të limituara ekzekutive siç parashihen në Nenet 3 dhe 3a – me qëllim të dorëzimit të detyrave të mbetura tek instrumentet e tjera afatgjata të BE-së dhe përfundimin e funksioneve të mbetura ekzekutive.”*
59. Më 8 qershor 2018, Përfaqësuesja e Lartë, nëpërmjet një letre, pranoi ftesën e Presidentit për vazhdim të mandatit të EULEX-it deri në datën e propozuar.
60. Letrat e Presidentit dhe të Përfaqësueses së Lartë përbëjnë Shkëmbimin e katërt të Letrave në mes të Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian.

61. Në bazë të të dhënave, deri më sot, në Republikën e Kosovës, lidhur me Shkëmbimin e katërt të Letrave, nuk është ndërmarrë asnjë veprim tjetër nga Presidenti apo nga Kuvendi.

Kërkesa e parashtruesit

62. Parashtruesi i kërkesës, fillimisht, përmes kërkesës së dorëzuar në Gjykatë të bazuar në paragrafin (9) të nenit 84 të Kushtetutës, kërkoi interpretimin e nenit 18 të Kushtetutës duke pretenduar paqartësi në lidhje me ratifikimin e Shkëmbimit të katërt të Letrave në mes Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian. Parashtruesi i kërkesës sqaroi se kjo paqartësi ndërlidhej me faktin se: (i) ky ishte Shkëmbimi i katërt i Letrave dhe tri të parat në vitet 2012, 2014, dhe 2016 respektivisht, ishin ratifikuar nga Kuvendi përmes ligjeve për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare; dhe (ii) për dallim nga tri rastet e para, Shkëmbimi i katërt i Letrave, redukton kompetencat e Misionit të EULEX-it, në kompetenca “*kryesisht*” këshillëdhënëse dhe monitoruese.
63. Pas sqarimeve të dorëzuara në Gjykatë më 24 dhjetor 2018, në bazë të kërkesës së kësaj të fundit të 11 nëntorit 2018, parashtruesi i kërkesës deklaroi se kërkesën në fjalë e ka ngritur si çështje të konfliktit të kompetencës kushtetuese në mes të Presidentit dhe Kuvendit, bazuar në nën-paragrafin (1) të paragrafit 3 të nenit 113 të Kushtetutës lidhur me kompetencat kushtetuese të përcaktuara në nenin 18 të Kushtetutës.
64. Presidenti, ngriti pretendime për çështje të konfliktit të kompetencës kushtetuese që ndërlidhen me kompetencat kushtetuese të Presidentit dhe Kuvendit lidhur me ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, si në vijim:

“1. Letrat e shkëmbimit në mes të Presidentit të Republikës së Kosovës (04.06.2018) dhe Përfaqësueses së Lartë të Bashkimit Evropian për Punë të Jashtme dhe Politika të Sigurisë (08.06.2018) [Shkëmbimi i Katërt i Letrave]:

- 1.1. a duhet të ratifikohen në cilësinë e Marrëveshjes Ndërkombëtare, nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, me votat e dy të tretave (2/3) të të gjithë deputetëve (në pajtim me Nenin 18.1. të Kushtetutës) apo*
 - 1.2. a duhet të konsiderohen të ratifikuara pas nënshkrimit nga Presidenti (në pajtim me Nenin 18.2 të Kushtetutës), për shkak të ndërrimit të rolit dhe mandatit ekzekutiv të Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë, pasi që tani e tutje do të ketë rol kryesisht këshillëdhënëse dhe monitorues.”*
65. Më specifikisht, në kërkesën e tij, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që pas shqyrtimit të pretendimit për konflikt të kompetencave kushtetuese në mes të Presidentit dhe Kuvendit të qartësohet se: *“a ka nevojë të bëhet ratifikimi i këtyre letrave [shih tek pjesa e fakteve: Shkëmbimi i Katërt të Letrave], në cilësinë e marrëveshjes ndërkombëtare, në pajtim me Nenin 18 (1) të Kushtetutës, siç është bërë në tri raste, në shkëmbimet paraprake të letrave [shih tek pjesa e fakteve: Shkëmbimi i Parë, i Dytë dhe i Tretë i Letrave] (...) apo në rastin konkret shkëmbimi i [katërt] letrave në mes Presidentit dhe*

Përfaqësueses së Lartë të Bashkimit Evropian për Punë të Jashtme dhe Politike të Sigurisë, mund të bëhet në pajtim me Nenin 18 (2) të Kushtetutës.”

66. Kërkesën e tij drejtuar Gjykatës, parashtruesi i kërkesës e arsyeton me nevojën *“për të shmangur çdo dilemë në ndërmarrjen e hapave të mëtejshme për hyrjen në fuqi të Marrëveshjes Ndërkombëtare (Shkëmbimit të Letrave)”* të nënshkruar nga Presidenti dhe Përfaqësuesja e Lartë.
67. Në këtë drejtim, parashtruesi i kërkesës thekson se dilema ndërlidhet me organin kushtetues kompetent për ratifikimin e marrëveshjes sepse tanimë roli i EULEX-it i përcaktuar përmes Shkëmbimit të katërt të Letrave *“kryesisht do të jetë këshillëdhënës dhe monitorues.”* Në këtë drejtim, parashtruesi thekson se *“të gjitha aktivitetet ekzekutive të ndërmarra nga EULEX KOSOVA deri më tani, lidhur me hetimet, ndjekjet, procedurat gjyqësore dhe të ekzekutimit do transferohen tek autoritetet e Kosovës dhe përfundojnë me 14 qershor 2018 dhe si rrjedhojë veprime do të ndërmerren ekskluzivisht nga autoritetet e Kosovës, ndërsa dokumentet dhe materialet tjera relevante, do t'u transferohen institucioneve kompetente të Kosovës më së voni deri më 14 dhjetor 2018.”*
68. Parashtruesi i kërkesës po ashtu theksoi se Gjykata, në pajtim me nenin 112 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës është autoriteti përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës dhe përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën. Në rastin konkret, parashtruesi i kërkesës thekson se është e nevojshme që të bëhet interpretimi i nenit 18 të Kushtetutës ashtu që të qartësohet kjo dispozitë kushtetuese lidhur me atë se Shkëmbimi i katërt të Letrave në mes të Presidentit dhe Përfaqësueses së Lartë *“a ka nevojë të ratifikohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës apo ratifikohen pas nënshkrimit të Presidentit.”*

Komentet e dorëzuara nga deputeti i Kuvendit, z. Korab Sejdiu, pas njoftimit të Gjykatës të datës 12 shtator 2018

69. Më 28 shtator 2018, deputeti i Kuvendit, z. Korab Sejdiu, ka dorëzuar komente në Gjykatë. Gjykata vëren se pas dorëzimit të sqarimeve nga parashtruesi i kërkesës më 24 dhjetor 2018 dhe pas njoftimit të dytë të Gjykatës drejtuar deputetëve të Kuvendit më 18 janar 2019 lidhur me sqarimet e dorëzuara të Presidentit për çështjen e *“konfliktit të kompetencave kushtetuese”* në mes të Presidentit dhe Kuvendit, Gjykata nuk pranoi ndonjë koment shtesë si përgjigje ndaj sqarimeve të dorëzuara nga Presidenti. Si rrjedhojë, në vijim, Gjykata do të paraqes vetëm komentet e dorëzuara në përgjigje të njoftimit të parë të Gjykatës.
70. Fillimisht, z. Korab Sejdiu kërkoi nga Gjykata *“ndërprerjen e menjëhershme të praktikës së shpërfilljes së tërësishme të Nenit 113 të Kushtetutës”* gjatë vendimmarrjes së saj, në rastet që ndërlidhen me kërkesat e parashtruara nga institucionet publike, përfshirë këtu edhe Presidentin. Ai pohon se *“të gjithë jemi dëshmitarë të pasojave që kanë rezultuar nga kjo praktikë antikushtetuese, mirëpo, kam shpresën që përbërja e re e kësaj Gjykate do të rezultojë me vendimmarrje në përputhje me Kushtetutën, e jo detyrimisht me precedentin e krijuar në kundërshtim me Kushtetutën.”*

71. Në kuptimin e pranueshmërisë së kërkesës, z. Korab Sejdiu ndërtoi argumentet e tij në kuptimin e papranueshmërisë së kërkesave në formën e *“pyetjeve kushtetuese”* të bazuar në nenin 84 (9) të Kushtetutës, duke theksuar ndër të tjera, se parashtruesi i kërkesës *“nuk është palë e autorizuar për të paraqitur këtë kërkesë kushtetuese, sepse Kushtetuta nuk ja njeh statusin e palës së autorizuar në asnjë rast tjetër, përpos atyre të përcaktuara shprehimisht me Kushtetutë.”* Lidhur me këtë ai theksoi se Presidentit *“nuk i njihet e drejta për të kërkuar interpretim “in abstracto” të dispozitave kushtetuese, përpos në rastet që lidhen shprehimisht me procedurat për të cilat ka juridiksion Gjykata me nenet 113.2 dhe 113.3.”*
72. Sipas z. Korab Sejdiu, përkundër faktit që në disa shtete si Gjermania parashihej me nenin 97 të Ligjit për Gjykatën Federale të Gjermanisë procedura e dërgimit të *“pyetjeve kushtetuese”*, në Republikën e Kosovës nuk parashihet një procedurë e tillë as në Kushtetutë dhe as në Ligj. Si rrjedhojë, ai konkludon se Gjykata nuk ka juridiksion për të shqyrtuar këtë kërkesë, pavarësisht faktit se parashtruesi i kërkesës *“është munduar të arsyetojë që neni 84 (9) i Kushtetutës i jep kompetencë për të referuar çështje kushtetuese.”*
73. Më tutje, dhe sa i përket përmbajtjes së kërkesës, z. Korab Sejdiu thekson se *“duke marrë parasysh se bëhet fjalë për ndryshim (amandamentim) të marrëveshjes ndërkombëtare ekzistuese, atëherë vjen në zbatim paragrafi 4 i nenit 18 të Kushtetutës i cili parasheh se ndryshimi apo tërheqja nga marrëveshja ndërkombëtare bëhet sipas të njëjtës mënyre sikurse ratifikimi i saj.”* Prandaj, sipas tij, në rastin konkret nuk ka asnjë paqartësi kushtetuese për tu interpretuar, por rasti konkret *“paraqet një veprim politik ndaj të cilit Gjykata do të duhej të zbatonte parimin e “vetëpërmbajtjes gjyqësore”, duke mos shërbyer si akter ndaj veprimeve të cilat e implikojnë atë si organ politik.”*
74. Gjithashtu, z. Korab Sejdiu thekson se Gjykata duhet ti jep vëmendje të veçantë kohës dhe rrethanave në të cilat parashtruesi i kërkesës po e parashtron këtë kërkesë, *“ku me çdo kusht po mundohet të gjejë mënyra që të tejkalojë kufizimet kushtetuese që ka pozita e tij si President i vendit.”* Ai po ashtu theksoi se: *“Gjykata Kushtetuese nuk duhet assesi të bie pre e tentativave të Parashtruesit që të shfrytëzojë këtë Gjykatë të nderuar si vegël për arritjen e qëllimeve të tij për anashkalim të Kuvendit si organi më i lartë në Republikën tonë parlamentare. Prandaj, ky moment me rëndësi jetike për Kosovën, kërkon vëmendje të proporcioneve historike nga të gjithë vendimmarrësit në këtë Gjykatë, dhe rrjedhimisht, vendime në përputhshmëri të plotë dhe strikte me atë çka thotë Kushtetuta dhe fryma mbi të cilën është hartuar nga hartuesit.”*
75. Deputeti, z. Korab Sejdiu përfundoi komentet e tij duke theksuar se: *“(a) parashtruesi i kërkesës nuk është palë e autorizuar; (b) Gjykata nuk ka juridiksion për të shqyrtuar kërkesa të kësaj natyre; (c) Gjykata duhet të rishikojë praktikën jokushtetuese të saj; (d) Çështja e paraqitur nuk përbën asnjë dilemë kushtetuese, asnjë konflikt për kompetencë mes organeve, por një veprim të pastër politik.”* Si rrjedhojë, ai kërkoi nga Gjykata që: (i) ta shpallë kërkesën të papranueshme; (ii) tua kumtojë vendimin palëve dhe

institucioneve të përfshira si palë në procedurë; dhe (iii) ta publikojë atë në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit.

Komentet e dorëzuara nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes VETËVENDOSJE!, pas njoftimit të Gjykatës të datës 12 shtator 2018

76. Më 28 shtator 2018, Grupi Parlamentar i Lëvizjes VETËVENDOSJE!, dorëzoi komente në Gjykatë. Gjykata vëren se pas dorëzimit të sqarimeve nga parashtruesi i kërkesës më 24 dhjetor 2018 dhe pas njoftimit të dytë të Gjykatës drejtuar deputetëve të Kuvendit më 18 janar 2019 lidhur me sqarimet e dorëzuara të Presidentit për çështjen e *“konfliktit të kompetencave kushtetuese”* në mes të Presidentit dhe Kuvendit, Gjykata nuk ka pranuar ndonjë koment shtesë si përgjigje ndaj sqarimeve të dorëzuara nga Presidenti. Si rrjedhojë, në vijim, Gjykata do të paraqes vetëm komentet e dorëzuara në përgjigje të njoftimit të parë të Gjykatës.
77. Grupi Parlamentar i Lëvizjes VETËVENDOSJE! theksoi se për nga mënyra e ratifikimit, Kushtetuta i ndan marrëveshjet ndërkombëtare në dy kategori kryesore. Sipas komenteve, në kategorinë e parë vendosen marrëveshjet ndërkombëtare që ratifikohen nga Kuvendi, sipas nenit 18 (1) të Kushtetutës; ndërkaq, në kategorinë e dytë vendosen marrëveshjet ndërkombëtare që ratifikohen me nënshkrimin e Presidentit, sipas nenit 18 (2) të Kushtetutës. Kjo e fundit, sipas tyre, gjithashtu *“ka përcaktuar çështjet për të cilat mund të lidhet marrëveshje ndërkombëtare dhe të cilat duhet të ratifikohen përmes miratimit të ligjit me 2/3 e të gjithë deputetëve (shih neni 60 i Rregullore së punës së Kuvendit të Kosovës).”* Ligji i cili kalon në Kuvend përmes procedurave të parapara me Rregulloren e Kuvendit ratifikon marrëveshjet ndërkombëtare duke iu dhënë atyre fuqi detyruese me karakter ndërkombëtar. Ata theksojnë se *“lidhja e marrëveshjeve ndërkombëtare është e drejtë e Republikës së Kosovës, të përcaktuar në nenin 17 të Kushtetutës, ratifikimi i marrëveshjeve ndërkombëtare është kusht për hyrjen në fuqi dhe zbatim të marrëveshjeve ndërkombëtare.”* Ratifikimi, sipas shpjegimeve të Grupit Parlamentar të Lëvizjes VETËVENDOSJE! *“në kuptimin e përgjithshëm është akti me të cilin organi kompetent i një shteti miraton një traktat/marrëveshje në mënyrë përfundimtare.”*
78. Sipas Grupit Parlamentar të Lëvizjes VETËVENDOSJE!, Shkëmbimi i katërt i Letrave në mes të Presidentit dhe Përfaqësueses së Lartë për vazhdimin e mandatit të EULEX-it deri më 14 qershor 2010 dhe *“marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara në Kuvendin e Kosovës të 7 shtatorit 2012, 15 majit 2014 dhe 29 qershorit 2016, ndërmyet të njëjtave palë, me çështje të rregulluara pothuajse njëjtë dhe natyrë të njëjtë juridike, duhet të vendoset në korpusin e çështjeve të përcaktuara në nenin 18 par. 1 lidhur me nenin 20 par. 1 të Kushtetutës, të cilat duhet të ratifikohen ekskluzivisht nga Kuvendi i Kosovës.”*
79. Grupi Parlamentar i Lëvizjes VETËVENDOSJE! thekson se nga përmbajtja e letrës së Presidentit drejtuar Përfaqësueses së Lartë *“shihet qartë se kompetencat ekzekutive do të vazhdojnë të ushtrohen nga EULEX KOSOVA në fushën e rendit publik dhe sigurisë, si përgjegjës i dytë i sigurisë në mbrojtje të dëshmitarëve dhe në mbështetje të dhomave të specializuara, si dhe*

Prokurorit të Specializuar në Kosovë.” Kësisoj, sipas tyre, rikonfirmohen “kompetencat ekzekutive të EULEX KOSOVA, të përcaktuara në marrëveshjet ndërkombëtare të mëhershme të ratifikuara me ligj, në Kuvendin e Kosovës (shih Marrëveshjen Ndërkombëtare të 16 qershorit 2018 dhe 29 qershorit 2016).” E njëjta përmbytje sipas tyre pasqyrohet edhe në Vendimin e Këshillit të Bashkimit Evropian përmes së cilit vazhdohet mandati i EULEX-it në Kosovë edhe për dy vite të tjera, përkatësisht deri më 2020. Bazuar nga kjo përmbytje, Grupi Parlamentar i Lëvizjes VETËVENDOSJE! shpreh qëndrimin se “natyra e letërkëmbimit është plotësisht e karakterit politik dhe që prek çështje themelore të kompetencave sovrane të institucioneve kushtetuese ekzekutive.”

80. Grupi Parlamentar i Lëvizjes VETËVENDOSJE! thekson se rasti konkret “duhet të ndërlihet edhe me nenin 20 të Kushtetutës i cili ka përcaktuar se, Republika e Kosovës, në bazë të marrëveshjeve të ratifikuara ndërkombëtare për çështje të caktuara, mund t’u kalojë kompetenca të caktuara shtetërore organizatave ndërkombëtare. Në mbështetje të nenit 18 par. 1 lidhur me nenin 20, par. 1 të Kushtetutës, si dhe të letërkëmbimit në mes përfaqësuesit të Kosovës dhe BE-së [Shkëmbimi i katërt i Letrave], vërehet qartë se Republika e Kosovës përmes kësaj marrëveshje ndërkombëtare, e cila konsiderohet e karakterit politik, ka nisur të pajtohet me ushtrimin e kompetencave të caktuara shtetërore në fusha të caktuara, konkretisht në fushën e rendit publik dhe të sigurisë nga EULEX KOSOVA. Andaj, një marrëveshje e tillë ndërkombëtare bie në korpusin e çështjeve të përcaktuara në nenin 18 par.1 të Kushtetutës së Kosovës, e cila duhet të votohet ekskluzivisht nga Kuvendi i Kosovës”.
81. Më tutje, Grupi Parlamentar i Lëvizjes VETËVENDOSJE! thekson se “duhet të interpretohet saktë periudha kohore e zbatimit të kësaj marrëveshje ndërkombëtare” duke qenë se në rastin konkret, “marrëveshja ndërkombëtare e cila ka hyrë në fuqi me datë 29 qershor 2016, ka paraparë zgjatjen e mandatit të EULEX KOSOVA në fusha të caktuara deri më 15 qershor 2018” dhe si e tillë “marrëveshja ndërkombëtare ka pushuar të prodhojë efekte juridike, si një akt me fuqi normative nga data e lartcekur, në territorin e Republikës së Kosovës.”
82. Më tutje, Grupi Parlamentar i Lëvizjes VETËVENDOSJE! pohon se, sipas nenin 18 (2) të Kushtetutës, “çdo marrëveshje ndërkombëtare e cila nuk ka natyrë të çështjeve të numëruara taksativisht në nenin 18 par.1, i lejohet Presidentit ti ratifikojë me nënshkrimin e tij.” Kësisoj, natyra e marrëveshjes ndërkombëtare shpreh gjithashtu edhe rëndësinë e saj në funksion të rregullimit të një çështje të caktuar por edhe procedurës që është e nevojshme për ratifikimin e saj. Marrëveshjet që parashihen me nenin 18 (2) të Kushtetutës janë të një rëndësie më të vogël dhe prandaj nuk i nënshtrohen ratifikimit nga Kuvendi dhe për të tilla çështje obligimi i vetëm i Presidentit është që vetëm të njoftojë Kuvendin.
83. Grupi Parlamentar i Lëvizjes VETËVENDOSJE! përfundon komentet e tyre drejtuar Gjykatës duke theksuar se dispozitat kushtetuese të parapara me nenin 17, paragrafët (1) dhe (2) të nenit 18, 19, 20, të Kushtetutës tregojnë “qartë, saktë dhe drejtë mënyrën e veprimeve procedurale të ratifikimit të një

marrëveshje ndërkombëtare.” Sipas tyre, “pyetjet kushtetuese nuk duhet të shtrohen për të shpjeguar një kompetencë kushtetuese, kur dihet saktë se ajo kompetencë i takon mbajtësit zyrtar dhe efektiv të sovranitetit shtetëror, siç është Kuvendi i Kosovës.”

Komentet e dorëzuara nga EULEX Kosova

84. Znj. Alexandra Papadopoulou, Shefe e Misionit të EULEX-it theksoi se EULEX-i nuk mund të shprehë asnjë qëndrimi lidhur me kërkesën nën shqyrtim nga Gjykata sepse EULEX-i nuk është pjesë e institucioneve të Kosovës, dhe bazuar në imunitetet dhe privilegjet e tyre, nuk mund të jenë palë në procedura në kuadër të juridiksionit të Kosovës.
85. Ajo më tej shtoi se nga perspektiva e Bashkimit Evropian, mandati i EULEX-it siç është përcaktuar në Veprimin e Përbashkët të Këshillit, miratuar më 4 shkurt 2008, dhe siç është ndryshuar me vendimet pasuese të Këshillit, dhe bazuar në Shkëmbimin e Letrave të 4 shtatorit 2012, 14 prillit 2014, 9 qershorit 2016 dhe 4 qershorit 2018, përbëjnë bazën e Misionit për të vazhduar mbështetjen për institucionet e Kosovës në fushën e sundimit të ligjit.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

86. Në mënyrë që të vendos lidhur me kërkesën e parashtruesit të kërkesës, Gjykata fillimisht duhet të vlerësojë nëse janë përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe Rregullore të punës.
87. Në këtë drejtim, Gjykata fillimisht i referohet nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës ku edhe përcaktohet juridiksioni i Gjykatës Kushtetuese për të vendosur lidhur me rastet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës, përkatësisht Presidenti.
88. Më specifikisht, Gjykata i referohet dispozitës përkatëse kushtetuese sipas të cilës Presidenti, në rrethanat e rastit konkret, mund të paraqitet si parashtrues para kësaj Gjykate:

Neni 113

[Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara]

(...)

3. Kuvendi i Kosovës, Presidenti i Republikës së Kosovës dhe Qeveria janë të autorizuar të ngrenë rastet në vijim:

(1) konflikti në mes të kompetencave kushtetuese të Kuvendit të Kosovës, Presidentit të Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Kosovës;

(...)

89. Gjykata po ashtu i referohet paragrafit (9) të nenit 84 [Kompetencat e Presidentit], të ndërlidhur me dispozitën e lartcekur, i cili përcakton:

“Presidenti i Republikës së Kosovës:

(...)

(9) mund të referojë çështje kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese;”

(...)

90. Sipas Kushtetutës dhe praktikës gjyqësore të kësaj Gjykate, autoriteti i Presidentit për të referuar çështje kushtetuese duhet të kuptohet në lidhje me dispozitat e Kushtetutës që kanë të bëjnë me juridiksionin e Gjykatës të përcaktuar me nenin 113 të Kushtetutës. (Shih, rastin e Gjykatës Kushtetuese, KO79/18, parashtrues *Presidenti i Republikës së Kosovës*, Kërkesë për interpretim të nenit 139, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Aktvendim për papranueshmëri i 3 dhjetorit 2018, paragrafët 72, 74, 77, 78 dhe 82).
91. Për tu kthyer tek rasti konkret, Gjykata vëren se Presidenti, në cilësinë e parashtruesit ka ngritur rast të konfliktit të kompetencës kushtetuese në mes tij dhe Kuvendit. Sipas pretendimit, në rastin konkret, nuk është e qartë kompetenca kushtetuese e paraparë me nenin 18 [Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare] të Kushtetutës lidhur me atë se a duhet të ratifikohet marrëveshja e nënshkruar përmes Shkëmbimit të katërt të Letrave në mes të Presidentit dhe Përfaqësueses së Lartë nga Kuvendi, sipas paragrafit 1 të nenit 18 të Kushtetutës, apo ratifikimin i së njëjtës është në kompetencë të tij, pra ajo hyn në fuqi pas nënshkrimit të Presidentit sipas paragrafit 2 të nenit 18 të Kushtetutës.
92. Gjykata vëren se neni 113.3 (1) i Kushtetutës ngërthen në vete tri kërkesa të nivelit kushtetues, përkatësisht domosdoshmërinë që (i) konflikti të ngritet nga njëra nga tri palët e autorizuara; që (ii) konflikti të ngritet për një kompetencë kushtetuese të caktuar me Kushtetutë për njërën nga tri palët e autorizuara dhe që (iii) të ketë një konflikt.
93. Për sa i takon (i) kërkesës së parë kushtetuese, Gjykata vëren që neni 113.3 (1) i Kushtetutës e autorizon Kuvendin, Presidentin dhe Qeverinë që të ngrenë rast të konfliktit në mes të kompetencave të tyre kushtetuese. Ky autorizim është i ndërsjellë dhe secili prej këtyre palëve të autorizuara mund të ngrenë çështje të konfliktit të kompetencave për njërën apo palën tjetër, duke mos përjashtuar mundësinë e ngritjes së konfliktit kundrejt dy palëve njëkohësisht. Në rastin konkret, kjo kërkesë kushtetuese plotësohet me faktin që kërkesa është parashtruar nga Presidenti kundrejt Kuvendit, si njëri nga tri palët e mundshme që janë të autorizuara për të ngritur çështje të konfliktit në mes të kompetencave të tyre respektive kushtetuese.
94. Për sa i takon (ii) kërkesës së dytë kushtetuese, Gjykata vëren që neni 113.3 (1) i Kushtetutës përcakton që konflikti mund të ngritet vetëm për një kompetencë kushtetuese të caktuar me Kushtetutë për njërën nga tri palët e autorizuara. Ndonëse Kushtetuta e lë të hapur objektin e konfliktit në mes të kompetencave kushtetuese, ajo bën një kufizim të rëndësishëm lidhur me atë se konflikti i supozuar i kompetencës kushtetuese duhet të burojë patjetër nga kompetencat

kushtetuese të përcaktuara me Kushtetutë për Presidentin, Kuvendin dhe Qeverinë. Në rastin konkret, edhe kjo kërkesë kushtetuese plotësohet me faktin që pretendimi për konflikt të kompetencës kushtetuese në mes të Presidentit dhe Kuvendit ndërlidhet me kuptimin e nenit 18 të Kushtetutës ku edhe përcaktohen kompetencat kushtetuese të këtyre dy palëve lidhur me ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare.

95. Për sa i takon (iii) kërkesës së tretë kushtetuese, Gjykata vëren që neni 113.3 (1) i Kushtetutës e përmend termin “konflikt” por nuk e specifikon tutje se çfarë nënkupton ky term. Konkretizimin e mëtutjeshëm të kësaj kërkesë kushtetuese dhe të këtij termi kushtetues e bën Ligji. Se a është përmbushur kjo kërkesë kushtetuese e nenit 113.3 (1) apo jo, Gjykata do ta përcaktojë pasi që të ketë shpjeguar kuptimin e këtij termi në raport me konkretizimin e tij të mëtutjeshëm me nenet 31 dhe 32 të Ligjit dhe rregullin 68 të Rregullores së punës.
96. Në këtë drejtim, Gjykata fillimisht vë në pah se ky është rasti i parë me kërkesë për vlerësim të pretendimit për “konflikt” në mes të kompetencave kushtetuese. Duke qenë se është e pamundur të përmbliidhen të gjitha rastet e mundshme që do të mund të paraqiteshin si dhe duke marrë parasysh faktin që Kushtetuta nuk e precizon objektin e konfliktit kushtetues që mund të paraqitet, Gjykata thekson secili rast i konfliktit në mes të kompetencave kushtetuese do të vendoset në dritë të rrethanave të secilit rast që parashtrohet, por bazuar në kushtet dhe limitet kushtetuese të parapara me Kushtetutë dhe më tej të specifikuar me Ligj dhe Rregullore të punës.
97. Para se të bëjë vlerësimin e kushtit të tretë të lartcekur kushtetues, Gjykata dëshiron po ashtu të vë në pah se gjuha e Kushtetutës, por edhe gjuha e Ligjit që e konkretizon më tej dispozitën kushtetuese të paraparë në nenin 113.3 (1), lë të kuptojë që kemi të bëjë me një juridiksion të Gjykatës Kushtetuese të karakterit preventiv, përkatësisht kontrolli kushtetues *ex-ante*, por që nuk përjashton as një kontroll kushtetues *ex-post*. Thënë ndryshe, pretendimi për konflikt “në mes të kompetencave kushtetuese”, që është gjuha e përdorur nga Kushtetuta, mund të paraqitet para se të ndodhë konflikti ose pasi që një konflikt kompetencash kushtetuese të ketë ndodhur. Në raste të tilla, Gjykata ka juridiksion që të vendos se a ekziston konflikti i pretenduar, a ka të bëjë rasti me kompetenca kushtetuese, a janë mbështetur mjaftueshëm pretendimet e ngritura për supozimin dhe pretendimin mbi ekzistimin e konfliktit të kompetencave kushtetuese, dhe, pas kalimit të testit të pranueshmërisë, të vendos se a janë cenuar të njëjtat nga ndonjëra palë në një rast konkret apo jo.
98. Rrjedhimisht, në mënyrë që të përgjigjet në pyetjen kyçe procedurale të rastit konkret se a ka “konflikt” dhe a është dëshmuar ekzistenca e një “konflikti” të mundshëm, Gjykata më tutje i referohet edhe kërkesave ligjore të përcaktuara me nenin 31 [Saktësimi i kërkesës] dhe 32 [Afatet] të Ligjit si dhe rregullin 68 [Kërkesa në pajtim me nenin 113.3 (1) të Kushtetutës dhe nenet 31 dhe 32 të Ligjit] të Rregullores së punës, si dispozita që e konkretizojnë më tutje dispozitën e lartcekur kushtetuese për “konflikt në mes të kompetencave kushtetuese”:

Neni 31
[Saktësimi i kërkesës]

Kërkesa e ngritur sipas nenit 113, paragrafi 3 (1) të Kushtetutës parashtrohet nga cilado palë e autorizuar në konflikt ose nga cilado palë e autorizuar që cenohet drejtpërdrejtë nga i njëjti konflikt. Kërkesa përmban çfarëdo informate të dobishme në lidhje me konfliktin e supozuar në pajtueshmëri me rregullat e procedurës së Gjykatës Kushtetuese.

Neni 32
[Afatet]

Kërkesa e ngritur në bazë të nenit 31 të këtij ligji parashtrohet brenda afatit prej gjashtë (6) muajve nga çasti i lindjes së konfliktit.

Rregulli 68
[Kërkesa në pajtim me nenin 113.3 (1) të Kushtetutës dhe nenet 31 dhe 32 të Ligjit]

- (1) Kërkesa e parashtruar sipas këtij rregulli duhet të përmbushë kriteret e përcaktuara me nenin 113.3, të Kushtetutës dhe me nenet 31 dhe 32 të Ligjit.*
- (2) Kur parashtron kërkesën në pajtim me këtë rregull, pala e autorizuar duhet të specifikojë saktë se çfarë konflikti ekziston ndërmjet kompetencave kushtetuese të Kuvendit të Kosovës, Presidentit të Republikës së Kosovës ose Qeverisë së Republikës së Kosovës.*
- (3) Pala e autorizuar duhet të identifikojë aktin, i cili shkel kompetencën e tij/saj dhe dispozitën përkatëse të Kushtetutës, e cila është shkelur nga një akt i tillë.*
- (4) Kërkesa sipas këtij rregulli duhet të dorëzohet brenda një periudhe prej gjashtë (6) muajsh nga dita në të cilën ka filluar konflikti i pretenduar.*
- (5) Sekretariati do të njoftojë autoritetin, akti i të cilit kontestohet. Ata mund të përgjigjen brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e njoftimit, përveç nëse tregohet arsye e mirë për një kohë më të gjatë dhe nëse zgjatja përkatëse miratohet.*

99. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se neni 31 i Ligjit përmban gjithsejt dy kërkesa ligjore që duhet të plotësohen; ndërkaq që neni 32 i Ligjit përmban gjithsejt një kërkesë të vetme ligjore.
100. Duke u nisur nga kërkesa e fundit e tri kërkesave të lartcekura ligjore të përcaktuara me nenet 31 dhe 32 të Ligjit, Gjykata fillimisht konstaton se rasti është ngritur brenda afatit 6 mujor të paraparë me nenin 32 të Ligjit, duke qenë se çasti i fillimit të “konfliktit të pretenduar” është data 8 qershor 2018, momenti kur Përfaqësuesja e Lartë e ka pranuar ftesën e Presidentit dhe ka finalizuar Shkëmbimin e Letrave; ndërkaq që kërkesa në Gjykatë është dorëzuar më 4 shtator 2018, pra para se të skadojë afati 6 mujor. Në këtë drejtim, Gjykata konstaton se kushti i përcaktuar me nenin 32 të Ligjit, në rrethanat e rastit konkret, është përmbushur.
101. Duke iu kthyer dy kushteve të para ligjore, Gjykata vëren se kërkesa e parë ligjore e nenit 31 të Ligjit është që rasti i ngritur sipas nenit 113.3 (1) të

Kushtetutës duhet të parashtrohet ose (i) nga pala e autorizuar në konflikt ose (ii) nga pala që cenohet drejtpërdrejt nga konflikti. Pra, mjafton që të ketë kërkesë të parashtruar në Gjykatë nga një palë e autorizuar që supozon apo pretendon të jetë në konflikt apo nga një palë e cila supozon apo pretendon se cenohet drejtpërdrejt nga konflikti. Kjo kërkesë plotësohet duke qenë se Presidenti, në cilësinë e parashtruesit të kësaj kërkesë, është palë që pretendon se është apo mund të jetë në konflikt. Kërkesa e dytë ligjore e nenit 31 të Ligjit është që në Gjykatë duhet të dorëzohen çfarëdo informata të dobishme në lidhje me *“konfliktin e supozuar”* apo të *“pretenduar”*. Lidhur me këtë pikë, Gjykata do ti referohet më poshtë edhe dy kërkesave shtesë të përcaktuara me paragrafët (2) dhe (3) të rregullit 68 të Rregullores së punës të cilat e konkretizojnë këtë dispozitë ligjore edhe më tutje dhe si të tilla duhet të vlerësohen bashkërisht dhe në mënyrë të përmblodhur, përkatësisht:

(2) Kur parashtron kërkesën në pajtim me këtë rregull, pala e autorizuar duhet të specifikojë saktë se çfarë konflikti ekziston ndërmjet kompetencave kushtetuese të Kuvendit të Kosovës, Presidentit të Republikës së Kosovës ose Qeverisë së Republikës së Kosovës.

(3) Pala e autorizuar duhet të identifikojë aktin, i cili shkel kompetencën e tij/saj dhe dispozitën përkatëse të Kushtetutës, e cila është shkelur nga një akt i tillë.

102. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se kushti i tretë kushtetues i nenit 113.3 (1) në lidhje me kushtin e dytë ligjor të nenit 31 të Ligjit, lexuar ngushtësisht me paragrafët (2) dhe (3) të Rregullores së punës, nuk plotësohen në rastin konkret.
103. Kjo për arsye se, sipas kësaj Gjykate, parashtruesi i kërkesës nuk ka dorëzuar mjaftueshëm informata të dobishme në lidhje me *“konfliktin e supozuar”* apo të *“pretenduar”*, siç kërkohet me nenin 31 të Ligjit e as nuk ka specifikuar *“saktë se çfarë konflikti ekziston ndërmjet kompetencave kushtetuese”* të Presidentit dhe Kuvendit, siç kërkohet me pikën (2) të rregullit 68. Rrjedhimisht, së fundi, ai nuk ka arritur të dëshmojë se si është cenuar kompetenca e tij e caktuar me Kushtetutë përkitazi me ratifikim të marrëveshjeve ndërkombëtare, siç parashihet me pikën (3) të rregullit 68 të Rregullores së punës.
104. Për të qartësuar tutje, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ndonëse është palë e autorizuar që pretendon të jetë në konflikt, ai nuk e ka specifikuar saktësisht se çfarë konflikti ekziston ndërmjet kompetencave kushtetuese të tij dhe Kuvendit, përkundër kërkesës së Gjykatës për të qartësuar kërkesën e tij të cilën fillimisht e kishte sjellë në formë të pyetjes kushtetuese në bazë të nenit 84 (9) të Kushtetutës. Pra, parashtruesi i kërkesës nuk ka specifikuar saktë se çfarë konflikti ekziston potencialisht përveç deklarimit të tij se ky rast *“ka të bëjë me konfliktin e kompetencave kushtetuese në mes Presidentit dhe Kuvendit”* për arsye se është e paqartë se Shkëmbimi i katërt i Letrave *“a ka nevojë të ratifikohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës apo ratifikohen pas nënshkrimit të Presidentit.”* Paqartësia në vetvete, e sidomos ajo e paargumentuar dhe e padëshmuar, jo medoemos mund të rezultojë e mjaftueshme për të ngritur një pretendim për konflikt në mes të kompetencave kushtetuese.

105. Po ashtu, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës e ka shtruar kërkesën e tij në formë të pyetjes dhe në mungesë të paraqitjes së argumenteve dhe dëshmimeve përkatëse se ku qëndron konflikti. Përveç kësaj, Gjykata vëren se, edhe pas kërkesës së Gjykatës për sqarim, parashtruesi i kërkesës nuk ka treguar apo elaboruar rreth asaj se si kompetencat e tij kushtetuese apo të Kuvendit do të mund të cenoheshin. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës citon nenin 18 të Kushtetutës si nen kontestues, mirëpo nuk saktëson dhe nuk *“specifikon saktë”* se si ky nen i cenon kompetencat e tij kushtetuese apo se si Kuvendi përmes këtij neni ia cenon atij kompetencat e tij kushtetuese.
106. Si rrjedhojë, Gjykata përfundimisht konstaton se parashtruesi i kërkesës nuk ka ofruar dëshmi dhe informata të dobishme për të ngritur një rast të konfliktit në mes të kompetencave kushtetuese të Presidentit dhe Kuvendit dhe se ai nuk e ka mbështetur kërkesën e tij mjaftueshëm, sipas kritereve të parapara me nenin 113.3 (1) të Kushtetutës, nenin 31 dhe 32 të Ligjit dhe rregullin 68 të Rregullores së punës.
107. Rrjedhimisht, Gjykata do ta deklarojë kërkesën të papranueshme.

Përfundime

108. Kërkesa e Presidentit të Republikës së Kosovës për konflikt të pretenduar në mes të kompetencave kushtetuese të tij dhe Kuvendit të Republikës së Kosovës shpallet e papranueshme për shqyrtim në merita për arsyet e elaboruara në këtë Aktvendim për papranueshmëri.
109. Në rastin konkret, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës nuk ka dorëzuar dëshmi dhe informata të dobishme përmes së cilave do të saktësohej dhe dëshmohej ekzistenca e konfliktit në mes të kompetencave kushtetuese të Presidentit të Republikës së Kosovës dhe Kuvendit të Republikës së Kosovës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenet 84 (9) dhe 113.3 (1) të Kushtetutës, nenet 31 dhe 32 të Ligjit dhe rregullat 59 (b) dhe 68 të Rregullores së punës, më 6 mars 2019, me shumicë,

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. TË KONSTATOJË se nuk është saktësuar dhe dëshmuar se ekziston një konflikt në mes të kompetencave kushtetuese të Presidentit të Republikës së Kosovës dhe Kuvendit të Republikës së Kosovës, siç përcaktohet me nenin 113.3 (1) të Kushtetutës;
- III. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- IV. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari që përgatiti vendimin

Bajram Ljati



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

